



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr 14/10 Prot

Vlorë, më 20 . 07 . 2023.

VENDIM

Nr. 6 , datë 13.07.2023

PËR

**MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR UJË TË
AMBALAZHUAR, TË SUBJEKTIT “DG” SH.P.K ME VENDNDODHJE: FSHATI
TATZAT, NJ.ADM VERGO, BASHKIA DELVINË, QARKU VLORË**

Në mbështetje të shkronjës “b” të pikës 2, të nenit 41, të ligjit nr.111/2012, “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujrave të pëdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Vjosë,

V E N D O S I:

1. Shtyrje për shqyrtim në mbledhjen e radhës të kërkesës për leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për ujë të ambalazhuar në rastin kur përdorimi është për > 151 shishe/orë, > 1 l/sek, të subjektit “DG” sh.p.k.
2. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Vjosë, për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

FLAMUR MAMAJ

